



ODA E AFARIZMIT TË KOSOVËS

Statuti i Shoqatës

Statuti i : ODA e AFARIZMIT të KOSOVËS / Chamber of Doing Business in Kosovo”

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse ODA e AFARIZMIT të KOSOVËS / Chamber of Doing Business in Kosovo” të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

1. Organizata do të quhet ODA e AFARIZMIT të KOSOVËS / Chamber of Doing Business in Kosovo”
2. Ajo mund të njihet edhe si OAK – CDBK
3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtarë të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donatorë të OJQ-së. Megjithatë, pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.
5. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj është e ndaluar, përveç nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij statuti dhe nenin 4 të Ligjit për Lirim të

Asocimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.

7. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në **Rr.Hamëz Jashari nr.28 Prishtinë.**

Neni 2

Themeluesit

1. Themelues të organizatës janë:

1. Arsim Selmonmusaj , rr. Fehmi Agani, Peje nga Kompania ELKOS
 2. Diamant Elshani , Fsh. Ozdrim, Peje, nga Kompania O3 Sh.PK.
 3. Skender Krasniqi , Rrr. Malush Kosova P.N. Prishtine, nga Agjencia e Lajmeve **KOSOVAPRESS**
2. Kuvendi i shoqatës vendos më shumicë votash pasi të këtë korum (emëron dhe shkarkon), përfaqësuesin e autorizuar të OJQ-së, i-e cili-a përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo është përgjegjës për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruara në rastin e regjistrimit të organizatës.

Neni 3

Qëllimi

1. Organizata është themeluar me qëllim të: jap kontribut në zhvillimin ekonomik të vendit, të promovojë bizneset vendore, të mbështesë dhe ndihmojë ndërmarrësit e rinj në fillim të punës, të mbrojë bizneset në të gjitha format e mundshme, të promovojë prodhimet vendore, në regjistrim e kompanive vendore dhe ndërkombëtare, në mbrojtjen e interesave të anëtarëve, të bëjë sondazhe, të krijojë raporte me shoqata simotra në Kosovë dhe jashtë vendit me institucione vendore dhe të huaja, ashtu që të krijojë politika ekonomike dhe klimë të favorshme të biznesit, të zhvillojë aktivitete në interes të biznesit përherë në kuadër të ligjeve në fuqi. Të ofrojë lehtësira në bashkëpunim dhe ndarje të ideve ndërmjet bizneseve që veprojnë në Kosovë, të përfaqësojë idetë, brengat dhe pikëpamjet e anëtarëve të saj tek institucionet publike dhe private në Kosovë, si dhe të ofrojë bashkëpunim me odat e tjera brenda dhe jashtë vendit e posaçërisht të ofrojë bashkëpunim edhe më të afërm me odat e rajonit.

2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

Promovimi i bizneseve;

Trajnime të ndryshme profesionale;

Udhëtime brenda dhe jashtë vendit me qëllim të krijimit të bashkëpunimit ekonomik;

Organizimi i ngjarjeve B to B;

Organizimi i panairove, organizimi i seminareve, mbajtje të konferencave për çështje me rëndësi biznesore duke përfshirë edukimin sa më adekuat të bizneseve.

Njëkohësisht, oda do të publikojë të gjitha raportet përmes ueb-sajtit zyrtar që përfshinë informata të rëndësishme dhe që mund të iu nevojiten anëtarve, duke përfshirë ndryshimet legislative dhe politikat që mund të ndikojnë në biznes.

Neni 4

Anëtarësimi

Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person fizik, juridik ose shoqatë që ka në posedim një certifikatë të regjistrimit përkatëse pranë institucioneve të Republikës së Kosovës, pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Kurse, vendimin final për pranim e miraton Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave. Gjithashtu, kompanitë apo personat e çfarëdo vendi të huaj por që kanë interesa biznesi në Kosovë.

Kushdo që është i interesuar për t'u anëtarësuar në organizatë, duhet të pranojë statutin dhe misionin e organizatës dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.

Kuvendi i shoqatës do të vendos nëse do të kërkohet pagesa e anëtarësimit nga anëtarët. Në rast të vendosjes së pagesës së anëtarësimit, Kuvendi do të vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësimit, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mospagesës së anëtarësisë.

Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të shoqatës në rast të moszbatimit të statudit të shoqatës ose mos pjesëmarrjes në aktivitete të shoqatës pa arsyetim. Në rast suspendimi, Kuvendi përcakton kohëzgjatjen.

Të gjithë anëtarët e odës do të marrin certifikatë të anëtarësisë.

Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i shoqatës do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5

Kuvendi i anëtarëve

1. Kuvendi i anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës, duke përfshirë edhe përfaqësuesit të deleguar nga personat juridikë ose organizatat, anëtare të shoqatës.

2. Kuvendi i anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kuadër, kuvendi i anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë zyrtarët në pozita udhëheqëse të shoqatës, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të marrë vendim për prioritetet e odës në lidhje me politikën e përgjithshme zhvillimore të vendit, përfshirë edhe ato publike, të interpretojë dhe ndryshojë statutin, si dhe të vendosë për bashkimin me odat dhe organizatat e tjera apo edhe të bëjë ndarjen. Kuvendi i përgjithshëm ka fuqinë ekzekutive për shuarjen dhe shpërndarjen e shoqatës. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulta.

3. Përpos përgjegjësive të rezervuara që ka, Kuvendi i Shoqatës gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi: pranimin dhe largimin e anëtarëve të shoqatës zgjedhjen e anëtarëve të Bordit .

4. Kuvendi i anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetëm Bordin ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësive të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të ligjit nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të neni 5 të këtij statuti.

Neni 6

Mbledhjet e Kuvendit të anëtarëve

1. Kuvendi i anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në mbledhjen e përgjithshme vjetore, ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe planin për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
2. Kuvendi i anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në mbledhjen e përgjithshme të jashtëzakonshme, kurdoherë që kërkohet nga 51 përqind të anëtarëve të kuvendit, duke i pas nënshkrimet e anëtarëve ose nga organet tjera të ndërmjetme. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet kryesuesit të kuvendit të anëtarëve, i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.
3. Lajmërimi me shkrim për mbledhja e përgjithshme vjetore ose mbledhja e përgjithshme e jashtëzakonshme, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen, i cili do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë (7) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes. Gjithashtu, para mbajtjes së mbledhjes, secili anëtar do ta ketë agjendën se çfarë do të diskutohet së paku katër ditë para takimit. Këto agjenda do të punohen nga drejtori ekzekutiv dhe do t'u shpërndahen anëtarëve së paku dy-tri ditë pune para takimit. Njëkohësisht, çdo anëtar ka mundësi që të propozojë pikë të agjendës vetëm nëse propozimet e tilla bëhen me kohë (së paku dy-tri ditë para takimit apo edhe në fillimin e mbledhjes, aprovimi i së cilës bëhet me shumicë votash).
4. Anëtarët që nuk i përgjigjen thirrjes për kuvend do të pajtohen me të gjithë vendimet që do të merren nga anëtarët prezent në kuvend. Vendimet do të jenë të plotfuqishme nëse merren me votimin e më shumë se 50 përqind të anëtarëve prezent në kuvend.
5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në kuvendin e anëtarëve.
6. Vendimet në kuvendin e anëtarëve do të merrën nga shumica e anëtarëve prezent.

Neni 7

Bordi Ekzekutiv

1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm do të jetë bordi ekzekutiv, i cili duhet të veprojë çdoherë në pajtim me qëllimin e organizatës dhe do të ketë mandat pesë (5) vjeçar.
2. Bordi do të ketë këto përgjegjësitë sipas listës së cekur më lartë.
3. Bordi zgjidhet nga kuvendi i shoqatës. Anëtarët do të zgjidhën individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm. Mënyra e zgjedhjes dhe rregullat e punës së anëtarëve të bordit mund të rregullohen me një rregullore të veçantë për punën e bordit, e cila aprovohet nga kuvendi i anëtarëve me shumicë votash.
4. Bordi do të ketë nëntë (9) anëtarë.

Bordi në përbërjen e tij ka:

Kryetarin e bordit; udhëheq të gjitha mbledhjet e kuvendit të përgjithshëm, si dhe do të udhëheq të gjitha mbledhjet e bordit.

Nënkryetarin e bordit; zëvendësonë kryetarin e bordit me kërkesë të kryetarit.

Sekretarin e përgjithshëm; do të përkujdeset që të ketë komunikim të mirëfilltë ndërmjet anëtarëve të bordit dhe kuvendit të përgjithshëm, si dhe ndërmjet odës dhe palëve të treta.

Arkëtarin: Do të ketë përgjegjësi të gjitha fondet e mbledhura dhe së bashku me kryetarin do t'i raportojnë të gjitha çështjet financiare para bordit, kurdo që kërkohet një gjë e tillë.

Bordi i Drejtorëve; do të ketë përgjegjësi ndaj anëtarëve të odës, si dhe do të jetë përgjegjës për një planifikim të mirëfilltë të odës. Njëkohësisht, bordi do të ketë përgjegjësi që të propozojë drejtorin ekzekutiv dhe ta menaxhojë atë. Po ashtu, do të rekomandojë ndryshimet e statutit aktual në mbledhjet e kuvendit të përgjithshëm në rast se paraqitet nevoja për ndonjë ndryshim, si dhe të përgatis buxhetin dhe synimet vjetore të odës dhe të njëjtat t'i prezantojë para kuvendit të përgjithshëm.

Buxheti nuk mundet të fillojë të shpenzohet pa e bërë miratimin kuvendi, miratimi duhet të bëhet në vitin paraprak për vitin e ardhshëm.

Mbledhja e parë e bordit udhëhiqet nga anëtari më i vjetër me mundësi të zëvendësimit të tij në rast mospërputhje me anëtarët e tjerë të bordit. Zëvendësimi bëhet me tubim të nënshkrimeve të shumicës së anëtarëve të bordit.

5. Anëtarët e bordit mund të zgjedhën edhe për mandate të njëpasnjëshme.

6. Anëtarët e bordit mund të suspendohen me së paku shtatë (7) vota të bordit, ndërsa, të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të shoqatës.

7. Mandati i anëtarit të bordit pushon:

Në rast të vdekjes,

dorëheqjes ose

shkarkimit nga kuvendi i anëtarëve.

8 Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të bordit, kuvendi i shoqatës duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur të mandatit.

9. Vendimet në bord merren me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

10. Bordi mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje kuvendit të anëtarëve për marrje të vendimit.

10. Kurrfarë pagese ose kompensimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të bordit pa aprovimin e më së paku pesë (5) anëtarëve të bordit ekzekutiv; kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatën.

Neni 8

Zyrtarët dhe nëpunësit

1. Në rast nevoje organizata punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Zyrtari kryesor ekzekutiv do të jetë drejtori ekzekutiv, i cili do të zgjidhet nga Kuvendi i shoqatës, kompetencat e të cilit do të rregullohen me rregulloren e punës së shoqatës.

2. Zyrtarët duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës. Të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen zyrtarit, si dhe obligimet dhe përshkrimin e punës dhe përgjegjësi të zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.

Neni 9

Shpërbërja e organizatës

1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit të anëtarëve.
2. Kur të vendos për shpërbërjen e organizatës, kuvendi i anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur, pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse Oda e Afarizmit Kosovarë.

Neni 10

Ndryshimet e statutit

1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendim nga dy e treta e anëtarëve prezentë të kuvendit të anëtarëve.

Neni 11

Periudhat e raportimit dhe viti financiar

1. Bordi dhe zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para kuvendit të anëtarëve në mbledhjen e përgjithshme vjetore ose kurdoherë që kërkohet nga një mbledhje e përgjithshme të jashtëzakonshme.
2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Neni 12

Menaxhimi i financave

Shoqata do të ketë llogari bankare:

Ky statut është aprovuar në Prishtinë

Nga anëtarëte Kuvendit

Më 11.11.2016

